

V E N D I M
Nr. 131, datë 26.2.1998

**PËR HARTIMIN E PROJEKTIT PARAPRAK “PËR REGJISTRIMIN E
PËRGJITHSHËM CIVIL TË POPULLSISË NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

(Ndryshuar me vendimin nr. 169, datë 6.3.1998)

(I përditësuar)

Me propozimin e Sekretariatit Shtetëror për Pushtetin Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Krijimin e grupit të punës për hartimin e projektit “Për regjistrimin e përgjithshëm civil të popullsisë në Republikën e Shqipërisë” dhe përgatitjen e projektligjit për aktet e gjendjes civile.

2. Në përbërje të grupit të punës të jenë përfaqësues të këtyre institucioneve: tre nga Sekretariati Shtetëror për Pushtetin Lokal, një nga Ministria e Shtetit për Reformën Legjislative dhe marrëdhëniet me Kuvendin Popullor, një nga Ministria e Shtetit për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ekonomik, dy nga Ministria e Drejtësisë, dy nga Ministria e Brendshme, një nga Ministria e Financave, një nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Gruas, dy nga Komisioni Qendror i Përhershëm i Zgjedhjeve, dy nga Instituti i Statistikës, një nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, një nga Instituti i Informatikës dhe një nga Fakulteti Ekonomik (katedra e statistikës-njësia e demografisë).

Brenda datës 1.3.1998, titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 2 të këtij vendimi të caktojnë përfaqësuesit e tyre në këtë grup pune dhe t’ia paraqesin Ministrit të Shtetit pranë Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

3. Grupi i punës kryesohet nga Ministri i Shtetit pranë Kryetarit të Këshillit të Ministrave, i cili miraton programin e punës dhe procedurat e veprimtarisë së këtij grupi.

Ministri i Shtetit pranë Kryetarit të Këshillit të Ministrave autorizon kryerjen shpenzimeve administrative dhe përcakton masën e shpërblimit të anëtarëve të grupit të punës.

4. Për hartimin e projektit paraparak grupi i punës mund të angazhojë specialistë vendas a të huaj të fushave përkatëse që lidhen me elementët përbërëse të projektit.

5. *Sekretariatit Shtetëror të Pushtetit Lokal i akordohen 5 milionë lekë nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave, për përballimin e shpenzimeve administrative për hartimin e projektit dhe shpërblimet e anëtarëve të grupit të punës, sipas autorizimeve të kryetarit të grupit të punës.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano